Bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 47 dhe 49, Udhëzimin nr.19, datë 31.5.2011 "Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin "Për kërkimin fundamental dhe ekselencë", Statutin e Universitetit, neni 27, si dhe vendimin e Senatit Akademik nr. 246, datë 01.06.2020 "Për miratimin e projektit Instalimi i platformes "Office 365 for Education" dhe "Upgrade i shërbimit të postës elektronike" për stafin akademik dhe studentët", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 03.06.2020

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Instalimi i platformes "Office 365 for Education" dhe "Upgrade i shërbimit të postës elektronike" për stafin akademik dhe studentët".
2. Ngarkohet Zv.Rektori për Shkencën dhe Projektet, Administratori i Universitetit dhe drejtoritë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 859 Prot.

Korçë, më 30.06.2020

VENDIM

Nr. 277, datë 30.06.2020

PËR
PAGESËN E ANËTARËVE TË SENATIT AKADEMIK DHE BORDIT
TË ADMINISTRIMIT PËR PERIUdhËN MAJ – QERSHOR 2020

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.267, datë 31.3.2020 «Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga pandemia Covid 19», si dhe shkresës së MARS-së nr.2191/1 Prot., datë 15.4.2020 protokolluar nga ana jonë me nr. 527/1 Prot., datë 16.04.2020 me lëndë «Kthim përgjigje»,

VENDOSI:

1. Pagesën e shpërblimit mujor të anëtarëve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për periudhën maj- qershor 2020, përjashtuar anëtarët që janë nëpunës të administratës shtetërore sipas VKM nr.267, datë 31.3.2020 «Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga pandemia Covid 19».
2. Shumat e papaguara të derdhen në buxhetin e shtetit, në fondin antiCOVID-19, të miratuar për vitin 2020, në bankën e nivelit të dytë Credins Bank, me numër llogarie në lekë nr.1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori dhe Drejtoria e Financës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 744 Prot.

Korçë, më 03.06.2020

VENDIM

NR. 250, DATË 03 06.2020

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 17, DATË 19.01.2020 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË "PËR MOSPËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR"

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 03.06.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të heqë nga lista bashkëlidhur Vendimi i Bordit të Administrimit nr.17, datë 19.01.2020, studenten Anxhela Pandeli Caci. Pas rishqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë Sekretarisë Mësimore si dhe dokumentit të lëshuar nga zyra noteriale, ku studentja ka kryer veprimet, u provua se librezat e jetimit në momentin e aplikimit ka qënë e noterizuar në përputhje me kërkesat e institucionit.
2. Për sa më sipër, Bordit i Administrimit vendosi të miratojë përfitimin e bursës, për studenten Anxhela Pandeli Caci, viti I, FEF, për vitin akademik 2019-2020.
3. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga muaji dhjetor 2019.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 982 Prot.

Korçë, më 17.07.2020

VENDIM

NR. 308, DATË 17.07.2020

PËR

**PËRFITIMIN E PERJASHTIMIT NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT
PER STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË
29.03.2017, "PER PERCAKTIMIN E KATEGORIVE TE INDIVIDEVE QE
PLOTESOJNE KRITERET E PRANIMIT NE NJE PROGRAM TE CIKLIT TE
PARE TE STUDIMEVE, NE NJE PROGRAM TE INTEGRUAR TE
STUDIMEVE OSE NE NJE PROGRAM TE STUDIMEVEPROFESIONALE QE
PERJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË
NDRYSHUAR**

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Per percaktimin e kategorive te individeve qe plotesojne kriteret e pranimit ne nje program te integruar te ciklit te pare te studimeve, ne nje program te integruar te studimeve ose ne nje program te studimeve profesionale, qe perjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.07.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë perjashtimin nga tarifa vjetore e studimeve për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 983 Prot.

Korçë, më 17.07.2020

VENDIM

NR. 309, DATË 17.07.2020

PËR

PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.07.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentët të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentët të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitim të bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 984 Prot.

Korçë, më 17.07.2020

VENDIM

NR. 310, DATË 17.07.2020

PËR

MOSPËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.07.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 985 Prot.

Korçë, më 17.07.2020

VENDIM

Nr. 311, datë 17.07.2020

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.07.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin për miratimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara për t'u nxjerrë jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit i ngritur sipas urdhrit të Administratorit nr. 178, datë 10.03.2020, sipas procesverbaleve dhe relacionit të paraqitur prej tyre, bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" (i ndryshuar), si dhe bazuar në dokumentacionin e inventarizimit fizik të aktiveve të përpiluar nga komisioni i inventarizimit, i ngritur sipas urdhrit të Administratorit nr. 37, datë 22.01.2020.

VENDOSI

1. Miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara për t'u nxjerrë jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit sipas procesverbaleve dhe relacionit (bashkangjitur materiali përkatës).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Bordit të Administrimit

Prof.as.dr Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 986 prot.

Korçë, më 17/07/2020

VENDIM

Nr. 312, datë 17/07/2020

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE
TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Bordi i Administrimit i mbledhur në datën 17.07.2020, pas diskutimit të kërkesës në lidhje me ndryshimet e Regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, bazuar në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë", neni 49 pika 1 si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenit 4, pika 4,

VENDOSI

Miratimin e ndryshimeve të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike si mëposhte.

PAKESUAR							
1	2020	Mobilje, Orendi	Kontrate	Mallra	4,040,000	3,366,667	Dhjetor
TOTALI						3,366,667	
SHTUAR							
1	2020	Shpenz. Paisje dhe instalimi i kondicionereve	Kontrate	Mallra	758,064	631,720	Dhjetor
2	2020	Rikonstrukcion Godina e Fakultetit te Ekonomise	Kontrate	Punë	3,281,936	2,734,946	Dhjetor
TOTALI						3,366,666	

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Mamica Nene



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1153 Prot.

Korçë, më 12.08.2020

VENDIM

Nr. 371, datë 12.08.2020

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR VJETOR DHE AFATMESËM
PËR PERIUdhËN 2021-2023

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika 1 "c", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr.88, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Udhëzimin nr.28, datë 10.7.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 12.08.2020, për miratimin e programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2021-2023 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim për periudhën 2021-2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2021-2023 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim për periudhën 2021-2023, sipas propozimit të Senatit Akademik të Universitetit nr. 1146 Prot., datë 12.08.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof. As.dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1146 Prot.

Korçë, më 12.08.2020

VENDIM

Nr. 370 datë 12.08.2020

PËR
MIRATIMIN PARAPRAKISHT TË PROGRAMIT BUXHETOR VJETOR
DHE AFATMESËM PËR PERIUdhËN 2021-2023

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1 "h", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr.88, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Udhëzimin nr.28, datë 10.7.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", Senati Akademik i mbledhur në datën 12.08.2020 për miratimin e programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2021-2023 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim për periudhën 2021-2023,

VENDOSI:


1. Të miratojë paraprakisht programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2021-2023 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim për periudhën 2021-2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Ali Jashari

Shëtitörja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unikorce.edu.al, rektorati@yahoo.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1474 prot

Korçë, më 30/09/2020

VENDIM

Nr. 497, datë 30.09.2020

PËR

**MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO
PROGRAM STUDIMI DHE TË TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PARAPRAK
PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Bazuar në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar, VKM nr.866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016" si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr.491, datë 29.09.2020 "Për miratimin e tarifave vjetore të shkollimit për çdo program studimi për vitin akademik 2020-2021", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.09.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2020-2021 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit të njëjtin nivel me ato të vitit akademik 2019-2020, përveç programeve të ciklit të parë bachelor të Fakultetit të Bujqësisë që ndryshojnë si në vijim si dhe miratimin e tarifës së programit të ri të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Arsim Special për Gjithëpërfshirjen" me vlerën 30.000 lekë për semestër.
 - Menaxhim Agrobiznesi ishte 20,000 bëhet 15,000 lekë,
 - Inxhinieri Agronomike ishte 20,000 bëhet 15,000 lekë,
 - Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë ishte 15,000, bëhet 20,000 lekë.
2. Miratimin e tarifave të regjistrimit paraprake 1,600 lek për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lek për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lek për të gjitha programet e dyta të studimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene

Shëtitörja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1475 Prot.

Korçë, më 30.09.2020

VENDIM

Nr. 498 datë 30.09.2020

PËR
PAGESËN E KOMISIONEVE ZGJEDHORE TË ANGAZHUARA NË
ZGJEDHJET PËR ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN
«FAN S.NOLI», KORÇË

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 47 dhe 49 si dhe propozimit të Senatit Akademik 1455 Prot, datë 29.09.2020 me lëndë "Projekt-propozim për shpërblimin e komisioneve zgjedhore të Universitetit «Fan S.Noli», Korçë"

VENDOSI:

1. Pagesën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore të angazhuara në zgjedhjet për organet drejtuese në universitetin «Fan S.Noli», Korçë sipas propozimit të Senatit Akademik të lartpërmendur. Lista e komisioneve dhe masa e shpërblimit për secilën kategori gjenden bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori dhe Drejtoria e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1478 Prot.

Korçë, më 30.09.2020

VENDIM

NR. 501, DATË 30.09.2020

PËR

**PËRFITIMIN E PERJASHTIMIT NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT
PER STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË
29.03.2017, "PER PERCAKTIMIN E KATEGORIVE TE INDIVIDEVE QE
PLOTESOJNE KRITERET E PRANIMIT NE NJE PROGRAM TE CIKLIT TE
PARE TE STUDIMEVE, NE NJE PROGRAM TE INTEGRUAR TE
STUDIMEVE OSE NE NJE PROGRAM TE STUDIMEVEPROFESIONALE QE
PERJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË
NDRYSHUAR**

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Per percaktimin e kategorive te individeve qe plotesojne kriteret e pranimit ne nje program te integruar te ciklit te pare te studimeve, ne nje program te integruar te studimeve ose ne nje program te studimeve profesionale, qe perjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 30.09.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë perjashtimin nga tarifa vjetore e studimeve për vitin akademik 2019-2020, per studentet e ciklit të parë të studimeve, "Bachelor" sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave te Natyres dhe Humane për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1476 Prot.

Korçë, më 30.09.2020

VENDIM

Nr. 499 datë 30.09.2020

PËR

NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AUTOBUSIT ME TARGË AA 177 BD

Bazuar në ligjin nr. nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe propozimit nr.1465 Prot., datë 30.09.2020, akt konstatimit datë 25.09.2020 dhe raportit të kontrollit teknik të mjetit

VENDOSI:

1. Nxjerrjen jashtë përdorimit të autobusit me targë AA 177 BD dhe kryerjen e veprimeve përkatëse të çregjistrimit përfundimtar.
2. Pas kryerjes së procedurave të përmendura në pikën 1, të fillojnë procedurat e shitjes për skrap të mjetit në formën e ankandit publik.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1477 Prot.

Korçë, më 30.09.2020

VENDIM

Nr. 500, datë 30.09.2020

PËR
KTHIMIN E TARIFËS VJETORE TË PAGUAR PËR VITIN
AKADEMIK 2019-2020

Bazuar në ligjin nr. nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe referuar me propozimit të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humanenr.1054 Prot., datë 29.07.2020 me lëndë «Propozim për kthim tarife vjetore», Bordi i Administrimit të Universitetit «Fan S.Noli» në mbledhjen e datës 30.09.2020, pas verifikimit të librezave dixhitale të secilit prej studentëve

VENDOSI:

1. T'ju kthehet tarifa vjetore e shkollimit e kryer për vitin akademik 2019-2020 studentëve të listuar në vijim:
 - Anxhela Bollguri 20,000 lekë (*nuk ka detyrime të pa paguara*)
 - Anxhela Abas 20,000 lekë (*nuk ka detyrime të pa paguara*)
2. T'ju kthehet pjesërisht tarifa vjetore e shkollimit e kryer për vitin akademik 2019-2020 studentëve të listuar në vijim pasi rezulton të kenë detyrime të pashlyera nga vitet e mëparshme akademike:
 - Nertila Bregu 10,000 lekë (*pa paguar tarifa vjetore 2018-19*)
 - Klevis Beqiraj 10,000 lekë (*pa paguar tarifa vjetore 2018-19*)
 - Brajan Qose 10,000 lekë (*pa paguar tarifa vjetore 2018-19*)
3. Të mos ju kthehet tarifa vjetore e shkollimit e kryer për vitin akademik 2019-2020:
 - Iva Kume (*Ka bërë kërkesë për rifillim studimesh dhe i janë ekuivalentuar notat në 2017-2018, por nuk ka paguar tarifën 20,000 lekë për vitin akademik 2017-2018*)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1697 Prot.

Korçë, më 23.10.2020

VENDIM

Nr. 584, datë 23.10.2020

PËR

ÇLIRIMIN NGA DETYRIMI PËR TARIFËN E STUDIMIT NË VITET
AKADEMIKE 2018-2019 DHE 2019-2020

Bazuar në ligjin nr. nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar kërkesës së studentit datë 14.10.2020, këkesës nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane datë 15.10.2020, vërtetimit datë 15.10.2020 si deklaratës së pedagogut datë 16.10.2020, Bordi i Administrimit të Universitetit «Fan S.Noli» në mbledhjen e datës 23.10.2020, pas shqyrtimit të dokumentacionit të sipërcituar

VENDOSI:

1. Çlirimin nga detyrimi për tarifën e studimit në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 për studentin **Ardi Muçllari**.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- Kërkesa e studentit Ardi Muçllari datë 14.10.2020,
- Këkesa nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane datë 15.10.2020,
- Vërtetim i kryesekretares Zarife Dhamo datë 15.10.2020
- Deklarata e pedagogut Aida Gambeta datë 16.10.2020

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1698 prot.

Korçë, më 23/10/2020

VENDIM

Nr. 585, datë 23/10/2020

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE
TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Bordi i Administrimit i mbledhur në datën 23.10.2020, pas diskutimit në lidhje me ndryshimet e Regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, bazuar në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë", neni 49 pika 1 si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenit 4, pika 4,

VENDOSI

Miratimin e ndryshimeve të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike si mëposhte.

PAKESUAR										
43	2020	Agregate baza prodhuese	Kontrate	Mallra	643,200	536,000	Te ardhurat	Kerkese per propozim	Dhjetor	
						536,000				
SHTUAR										
53	2020	Shpenz.Instalimi i sistemit te kompjuterave (licenca server, kompj)	Kontrate	Mallra	643,200	536,000	Te ardhurat	Prok.me vlere te vogel	Dhjetor	
						536,000				

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1901 prot

Korçë, më 23/11/2020

VENDIM

Nr. 637, datë 23.11.2020

PËR

MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA
BACHELOR NË "ADMINISTRIM BIZNESI NË TURIZËM" NË BACHELOR
NË "MENAXHIM NË TURIZËM DHE MIKPRITJE"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 70, pika 3, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi propozimin e Rektorit të Universitetit bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.606, datë 29.10.2020, në mbledhjen e datës 23.11.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimit nga bachelor në "Administrim Biznesi në Turizëm" në bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ofruar në 3 vite akademike me 180 kredite nga Departamenti Marketing-Turizëm, për vitin akademik 2021-2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1902 prot

Korçë, më 23/11/2020

VENDIM

Nr. 638, datë 23.11.2020

PËR

MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA
MASTER PROFESIONAL NË "TURIZËM" NË MASTER PROFESIONAL
NË "MENAXHIMI I TURIZMIT, ATRAKSIONEVE DHE EVENTEVE"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 70, pika 3, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi propozimin e Rektorit të Universitetit bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.605, datë 29.10.2020, në mbledhjen e datës 23.11.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimit nga Master Profesional në "Turizëm" në Master Profesional në "Menaxhimi i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve" ofruar në 1 vit akademik me 60 kredite nga Departamenti Marketing-Turizëm, për vitin akademik 2021-2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1903 prot

Korçë, më 23/ 11 / 2020

VENDIM

Nr. 639, datë 23.11.2020

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER
PROFESIONAL" NË "MARKETINGU DIXHITAL"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 70, pika 3, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi propozimin e Rektorit të Universitetit bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.604, datë 29.10.2020, në mbledhjen e datës 23.11..2020

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ri të studimit "Master Profesional" në "Marketingu Dixhital" ofruar në një vit akademik me 60 kredite, nga Departamenti Marketing-Turizëm për vitin akademik 2021-2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1904 prot

Korçë, më 23/ 11 / 2020

VENDIM

Nr. 640, datë 23. 11. 2020

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER
PROFESIONAL" NË "MËSUESI NË ARSIM SPECIAL
PËR GJITHËPËRFSHIRJEN"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 70, pika 3, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi propozimin e Rektorit të Universitetit bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.492, datë 29.09.2020, në mbledhjen e datës 23.11..2020

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ri të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Arsim Special për Gjithëpërfshirjen" ofruar në një vit akademik me 60 kredite, nga Departamenti i Edukimit për vitin akademik 2021-2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1905 prot

Korçë, më 23/11/2020

VENDIM

Nr. 641, datë 23.11.2020

**PËR
MIRATIMIN E RISTRUKTURIMIT TË PROGRAMIT EKZISTUES
TË CIKLIT TË PARË BACHELOR "AGROBIZNES" NË "MENAXHIM
AGROBIZNESI"**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 70, pika 3, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi propozimin e Rektorit të Universitetit bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.163, datë 21.02.2018, në mbledhjen e datës 23.11.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë rristurimin e programit ekzistues të ciklit të parë bachelor "Agrobiznes" në "Menaxhim Agrobiznesi", ofruar në 3 vite akademike me 180 kredite nga Departamenti i Agrobiznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2044 Prot.

Korçë, më 15.12.2020

VENDIM

Nr. 675, datë 15.12.2020

PËR
PAGESËN E NGARKESËS SË ORËVE TË REALIZUARA JASHTË
AUDITORIT PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Bazuar në ligjin nr. nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, kreu II pika 1 dhe kreu III pika 3 si dhe vendimin e Senatit Akademik nr.668, datë 11.12.2020 me objekt «Për realizimin e ngarkesës të orëve jashtë auditorit për vitin akademik 2019-2020», Bordi i Administrimit në mbledhjen online të datës 14.12.2020,

VENDOSI:

1. Të paguhet ngarkesa e orëve të realizuara jashtë auditorit për vitin akademik 2019-2020, në përputhje me vendimin e Senatit Akademik nr.668, datë 11.12.2020 me objekt «Për realizimin e ngarkesës të orëve jashtë auditorit për vitin akademik 2019-2020», sipas detajimit të mëposhtëm:

Orë gjithsej jashtë auditorit	Orë të pagueshme jashtë auditorit deri në 100 orë	Pagesa bruto 100%	Orët e pagueshme 75 %	Pagesa Bruto
12,586	11,165	10,128,360	8,374	7,573,996

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2045 prot

Korçë, më 15/ 12 / 2020

VENDIM

Nr. 676, datë 15.12.2020

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
ME "UBT", PRISHTINË,
"MASTER SHKENCOR" NË "TË NXËNËT, EDUKIMI DHE TEKNOLOGJIA"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 49 dhe 80, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Statutin e UNIKO, si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr.667, datë 11.12.2020 me objekt "Për miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit me "UBT", Prishtinë, "Master Shkencor" në "Të nxënët, edukimi dhe teknologjia", Bordi i Administrimit në mbledhjen online të datës 14.12.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të studimit me "UBT", Prishtinë, "Master Shkencor" në "Të nxënët, edukimi dhe teknologjia", në përputhje me Vendimin e Senatit Akademik nr.667, datë 11.12.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2094 Prot.

Korçë, më 23.12.2020

VENDIM

Nr. 687, datë 23.12.2020

PËR
KRYERJEN E PAGESËS SË TAKSËS SË ANËTARËSIMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2019-2020 NDAJ FEDERATËS SHQIPTARE TË SPORTIT
UNIVERSITAR

Bazuar në ligjin nr. nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar kërkesës së rektorit nr.2069 Prot., datë 21.12.2020 me lëndë «Kërkesë» dhe pikës 2 të vendimit të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar nr.3, datë 15.02.2018 me objekt «Mbi taksën vjetore të anëtarësimit në F.SH.S.U»

VENDOSI:

1. Të paguhet taksa vjetore e anëtarësimit në F.SH.S.U për vitin akademik 2019-2020 sipas faturës nr.20 (serial 12670212), datë 20.11.2020 në vlerën 100,000 lekë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2095 Prot.

Korçë, më 23.12.2020

VENDIM
NR. 688, DATË 23.12.2020

PËR

PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË" (e ndryshuar)

Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 23.12.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentët të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2020-2021, për studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor" dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Prof. as. dr. Mamica NENE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2096 Prot.

Korçë, më 23.12.2020

VENDIM

NR. 689 DATË 23.12.2020

PËR

MOSPËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË", (i ndryshuar)

Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 23.12.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2020-2021, për studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Prof. as. dr. Mamica NENE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2097 Prot.

Korçë, më 23.12.2020

VENDIM

Nr. 690, datë 23.12.2020

PËR MËNYRËN E PAGESËS SË SHKOLLËS NGA STUDENTËT
QË TRANFEROJNË STUDIMET

Bazuar në ligjin nr. nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar shkresës së dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë nr.1779 Prot., datë 02.11.2020 me lëndë "Sqarim për mënyrën e pagesës së shkollës nga studentët e programeve Master Profesional 90 kredite që kanë transferuar studimet tek programet Master Profesional me 120 kredite", dhe shkresës nr.1779/2 Prot., datë 01.12.2020 me lëndë "Kthim përgjigje shkresës nr.1779/1 prot., datë 23.11.2020", Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 23.12.2020

VENDOSI:

1. Studentët që transferojnë studimet nga Master Profesional 90 kredite tek programet Master Profesional me 120 kredite të kryejnë pagesën e shkollës sipas krediteve që këta studentë kanë për të shlyer, paraqitur nga kërkesa e Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe relacionit bashkëngjitur shkresave të sipërcituara.

Detajimi si në vijim:

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Programi ku transferohen studimet	Numri i krediteve për t'u shlyer
1	Fabiola Kiço Bitri	Master Profesional - Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsinë	59
2	Brisida Riza Zhuli	Master Profesional - Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsinë	34
3	Enxhi Guri Haxhillari	Master Profesional - Mësues për Gjuhën Angleze	53
4	Sidorela Adriatik Kuqo	Master Profesional - Mësues për Gjuhën Angleze	54

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Financës.
3. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK, BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2112 prot

Korçë, më 28/12/2020

VENDIM

Nr. 693, datë 28.12.2020

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE,
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE FINANCIARE PËR VITIN AKADEMIK
2019-2020

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, "Funksionet e Senatit Akademik", pika 1, gërma g, si dhe neni 49, "Funksionet e Bordit të Administrimit në Institucionet e arsimit të lartë", pika 1, gërma h, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pasi diskutuan mbi raportin vjetor të veprimtarisë të institucionit për vitin akademik 2019-2020, të hartuar nga Rektorati i Universitetit si dhe duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", pika 4, në mbledhjen e përbashkët të datës 28.12.2020

VENDOSËN:

1. Të miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe financiare të vitit akademik 2019-2020, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Prof.as.dr. Mamica Nene



KRYETARI I SENATIT
REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello